

NË EMËR TË POPULLIT

04.06.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], komuna e Ferizajt, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.379-4/15 të dt.22.09.2015 për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor, me dt.28.04.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.379-4/15 e dt.22.09.2015 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt, i lindur me dt. [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] qiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me datën 22.02.2015 rreth ores 18:40 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, në rajonin ekonomiko-pyJOR Neredime-Jezerc, në vendin e quajtur "Braka" me qëllim vjedhje ka prerë 2 drunjë të llojit ahu, me diameter 39-52 cm, lartësi prej 26 m, gjithësej në kubaturë prej 4.04 m/kub, vlera e demit të shkaktuar është 545,40 € të cilat drunjë I ka bartur me gjip të markës Landrover.

Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së.

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 Euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 545,40 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.379-4/15 dt.22.09.2015 ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt për veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë kallzimin penal nr.114/2015 dt.16.03.2015, fletëparaqitjen e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj nr.114/2015 e dt.16.03.2015 si dhe procesverbalin mne të njëjtin numër, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 545,40 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmerise së ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.1100/2015 dt.28.04.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.